



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTRY OF HEALTH	
Njësie Org.	01
Org.Jedinica	
Org Unit	
Nr.i faqeve	-23-
Dr.stranica	
No.pages	
Nr.Prot:	25-1910
Broj Prot:	
Prot.No:	
Data:	
Datum:	
Dato:	14.04.2020
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Shëndetësisë**  
**Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health**  
**Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister**

Nr. 238/IV/2020  
Datë.14.04.2020

Në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë përbazë nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës; nenin 12 paragrafi 1.11 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi; nenin 8, paragrafi 1.4 dhe Shtojcën 10 paragrafi 1 të Rregullores nr.05/2020 përfushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive (19.02.2020); nenet 3, 4, 33, 41, 44, 47 dhe 53 të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse; nenet 44, 46 dhe 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; dhe nenin 27 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative; në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020, si dhe në përpunëtje të plotë me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr. KO54/20, ministri në detyrë i Ministrisë së Shëndetësisë, nxjerr:

**V E N D I M**

**për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19  
në territorin e Komunës së Dragashit**

**I. Prej datës 15 prill 2020 në orën 06:00, ndalohet qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komunën e Dragashit përvèç rasteve në vijim:**

- Për personat fizikë mbi moshën 16 vjeçare lejohet qarkullimi përfurnizim me mallra të domosdoshme (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë, si dhe produkte higjenike) dhe përtë kryer detyrat dhe nevojat financiare (pagesat, punët bankare), **vetëm për 1 orë e gjysmë në ditë**, sipas orarit të përcaktuar favor në bazë të shifrës së parafundit të numrit të tyre personal. Orari është i bashkëngjitur këtij vendimi (shih Aneksin 1) dhe do t'i nënshtrohet rotacionit dy herë në javë. Për shtetasit e huaj që nuk posedojnë numër personal të Republikës së Kosovës, orari i lejuar i daljes përcaktohet bazuar në shifrën e parafundit të numrit të pasaportës ose të letërnjoftimit të shtetit të huaj.**
- Gjatë qarkullimit të personave fizikë, **nuk lejohet shoqërimi nga askush**, përvèç në tri raste:
  - personat me aftësi të kufizuara**, të cilët mund të shoqërohen vetëm nga një anëtar jetët i së njëjtës bashkësi familjare, apo nga një asistent mjekësor/shëndetësor.

- (2) **personat nën moshën 16 vjeçare**, me kusht që të jenë të shoqëruar nga një anëtar i së njëjtës bashkësie familjare.
- (3) **kafshët shtëpiake**, me kusht që të mbahen të lidhura në çdo kohë gjatë orarit të lejuar të daljes.
- (c) Gjatë orarit 90-minutësh të lëvizjes së lirë në bazë të numrit personal, personat fizikë mund të dalin jashtë banesave/shtëpive të tyre për të kryer ushtrime fizike. Përveç përjashtimeve në pikën (b), **nuk lejohet shoqërim nga askush gjatë kryerjes së ushtrimeve fizike**.
- (d) Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të COVID-19 ndaj të mosuhanve, **rekomandohet** që personat mbi moshën 65 vjeçare të mos dalin nga shtëpia/banesa, përveç për raste urgjente dhe kur është e domosdoshme.
- (e) Me dokument konfirmimi nga ATK EDI dhe **vetëm për të kryer nevojat e operatorëve ekonomikë apo institucioneve përkatëse**, mundësohet:
  - (1) qarkullimi i lirë për operatorët ekonomikë dhe institucionet e parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi 2 dhe 3 të këtij vendimi.
  - (2) transporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit — si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit — për veprimitaritë e lejuara sipas Anekxit 2 të këtij vendimi.
- (f) Lejohet qarkullimi i lirë për institucionet në listën e bashkëngjitur si Aneksi 3 i këtij vendimi, **vetëm për të kryer detyrat zyrtare**.
- (g) Në raste urgjente të shëndetësisë, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të kërkuar trajtim mjekësor në një institucion shëndetësor.
- (h) Lejohet qarkullimi për personat fizikë në raste ku dalja nga shtëpia/banesa është e domosdoshme për t'u kujdesur për një ose më shumë të sëmurë, ose për një ose më shumë persona me aftësi të kufizuara, **vetëm nëse të sëmurët apo personat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi të kujdesen përvetës**.
- (i) Ndalimi i qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre nuk zbatohet në raste të viktimate të dhunës familjare. Viktimave të dhunës familjare u lejohet të dalin nga shtëpitë/banesat e tyre për të kërkuar strehim në një lokacion alternativ.
- (j) Në raste të vdekjes, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të marrë pjesë në varrim, **por vetëm për familjarët e ngushtë të të ndjerit**.
- (k) Ndalohet rreptësisht dalja nga shtëpitë/banesat për çfarëdo arsyë tjetër përvëç për arsyet e lartëkura, duke përfshirë në këtë ndalim takime shoqërore, vizita familjare, etj.

## **II. Prej datës 15 prill në orën 06:00, ndalohet qarkullimi i automjeteve në Komunën e Dragashit, përvëce:**

- (a) Me dokument konfirmimi nga ATK sistemi EDI dhe **vetëm për të kryer nevojat e operatorëve ekonomikë**, mundësohet:
  - (1) qarkullimi i automjeteve për operatorët ekonomikë dhe institucionet e parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi 2 dhe 3 i këtij vendimi.
  - (2) lëvizja e punëtorëve, vetëm për të shkuar në punë dhe për t'u kthyer nga puna, sipas orarit të operatorit përkatës ekonomik. Punëtori ka të drejtë të shfrytëzojë edhe veturën personale.
  - (3) transporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit — si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e

shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit — për veprimtaritë e lejuara sipas Aneksit 2 të këtij vendimi.

- (b) Orari i qarkullimit për bujqit dhe punonjësit në fermë është 06:00 – 20:00. Për bujqit, në kohën e qarkullimit nevojiten: (i) Certifikata e Regjistrimit të Fermerit, (ii) Aneksi 1 i Certifikatës – Shënimet e Fermerit të Regjistruar dhe (iii) Letërnjoftimi.
- (c) Punonjësit e fermave do të pajisen me dokument konfirmimi nga MBPZhR vetëm për të kryer nevojat e punës në fermën përkatëse.
- (d) Me leje të veçantë të qarkullimit dhe **vetëm për të kryer nevojat e institucioneve shtetërore**, lejohet qarkullimi i automjeteve për stafin esencial të këtyre institucioneve.
- (e) Lejohet qarkullimi me automjete për personat të cilët marketin/barnatoren/bankën/pikën e pagesës më të afërt e kanë më shumë se 2km larg. Në këto raste, nuk lejohet përdorimi i automjetit për të udhëtar te ndonjë market/barnatore/bankë/pikë e pagesës përveç atij më të afërt.
- (f) **Vetëm për të kryer detyrat zyrtare**, lejohet qarkullimi i automjeteve për institucionet në listën e bashkëngjitur si Aneksi 3 i këtij vendimi.
- (g) Lejet për qarkullim në raste të specifikuara më sipër nga Aneksi 3 lëshohen nga MPBAP.
- (h) Lejohet qarkullimi i automjeteve për personat me aftësi fizike të kufizuara që e bëjnë të domosdoshëm përdorimin e automjeteve.
- (i) Lejohet përdorimi i automjetit për të udhëtar te një institucion shëndetësor për të kërkuar trajtim.
- (j) Në raste të vdekjes, lejohet përdorimi i automjetit për të marrë pjesë në varrim, **por vetëm për familjarët e ngushtë të të ndjerit**.
- (k) **Përveç për arsyen e përcaktuara në pikën I, nuk lejohet më shumë se dy persona në një automjet**.
- (l) Përjashtmisht, ekipet e mediave të cilat punojnë në terren lejohen të kenë deri në 3 persona në automjet me kusht që të 3 pasagjerët të kenë maskë speciale FFP2 plus dorëza të vendosura.

### **III. Gjatë qarkullimit të lejueshëm sipas përjashtimeve të parashikuara në pikat I dhe II më lart, personat fizikë obligohen:**

- (a) të mbajnë të mbuluara vetëm gojën dhe hundën, përmes maskës, shallit, apo ndonjë mbulese tjeter;
- (b) në çdo kohë, të ruajnë distancë prej dy metresh nga persona të tjerë.

### **IV. Mosrespektimi i masave të përcaktuara në këtë vendim konsiderohet, sipas ligjit, si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, prej 1,000 Euro deri në 2.000 Euro për personat fizikë dhe prej 3,000 Euro deri në 8.000 Euro për personat juridikë, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet prej 500 Euro deri me 1,500 Euro. Në përputhje me ligj, gjobat shqiptohen nga Inspektorati kompetent.**

### **V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjtë vlen deri më **4 maj 2020**. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet çdo dispozitë e mëparshme që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Vendimi.**

**VI. Ky vendim do të rishqyrtohet** jo më vonë se **30 prill 2020**, në konsultim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, ekspertët dhe ministritë e tjera të linjës, për të vlerësuar efikasitetin dhe domosdoshmërinë e masave të përcaktuara, si dhe për të vendosur përvazhdimin ose jo të masave përkatëse.

**VII.** Përveç pikës V dhe VI, Ministri i Shëndetësisë do ta ri-analizojë situatën epidemiologjike çdo ditë dhe në lidhje me secilën pikë të lartcekur dhe, pas konsultave paraprake, mund të ndryshojë, plotësojë apo shfuqizojë masat e përcaktuara.

## **ARSYETIM**

Më 11.03.2020, duke miratuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendimin Nr. 01/07, përmes të cilit janë marrë masat e para për parandalimin dhe luftimin e infekzionit COVID-19. Pas konfirmimit të rasteve të para të personave të infektuar, në përputhje me rekomandimet e IKShPK, Ministria ka kërkuar nga Qeveria nxjerrjen e vendimeve të tjera përmes të cilave janë marrë masa shtesë për parandalimin dhe luftimin e sëmundjes COVID-19.

Më 23.03.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendimin Nr. 01/15 përmes të cilit janë marrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Më 31.03.2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka njoftuar opinionin se pas kontestimit të vendimit të Qeverisë Nr. 01/15 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, ka miratuar kërkesën e të njëjtit dhe ka shpallur të pavlefshëm vendimin e kontestuar. Mirëpo në të njëjtin vendim, Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar se Ministria e Shëndetësisë vazhdon të jetë e autorizuar që të nxjerr vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sëmundjes COVID-19, për aq sa është e autorizuar përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitése dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Sipas nenit 47.1 të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitése, “*Ministria e Shëndetësisë është kompetente për zbatimin e këtij ligji dhe për miratimin e dispozitave të parapara me të*”.

Sipas nenit 41.2 të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitése, për ta parandaluar futjen dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitése në tërë vendin, Ministria e Shëndetësisë është e autorizuar për “*ndalimin e qarkullimit në rajonet e infektuara ose drejtpërsëdrejti të rrezikuara*”. Në datën 12.04.2020, IKShPK i propozoi Ministrisë së Shëndetësisë marrjen e masave të theksuara në dispozitivin e këtij vendimi për komunën e Dragashit, për shkak se IKShPK konsideron se infekzioni është përhapur në atë komunë apo e njëjtë konsiderohet drejtpërsëdrejti e rrezikuar. Me qëllim që Ministria e Shëndetësisë t’i përbushë obligimet ligjore për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve i aprovoi propozimet e IKShPK sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, në përputhje me gjendjen faktike dhe juridike të përshkruar në këtë arsyetim, Ministri i Shëndetësisë vendosi si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

*Pala e pakënaqur mund të ushtrojë  
padi të konfliktit administrativ  
në Gjykatën Themelore në Prishtinë  
Departamentin për Çështje Administrative*

në afat prej 30 ditësh pas publikimit të këtij vendimi.

Arben Vitia



Vendimi iu dërgohet:

- Kryeministrin të Republikës së Kosovës;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;
- Sekretarit të Përgjithshëm MSh,
- Departamentit Ligjor MSh,
- IKSHPK-së;
- Kryetarit/es të Komunës;
- Policisë së Kosovës;
- Inspektoratit sanitar;
- Qendrës operative emergjente në MSh;
- Arkivit të MSh.

**ANEKS 1 - INTERVALET KOHORE TË LEJIMIT TË LËVIZJES SË QYTETARËVE:**

DATAT E QARKULLIMIT SIPAS ORARIT MËPOSHTË		15/04/2020 – 17/04/2020
ORARI I LËVIZJES	SHIFRA E PARAFUNDIT E NR PERSONAL	PËR LLOJIN E FURNIZIMEVE TË QYTETARËVE
07:00 - 08:30	0 dhe 1	DREJT OPERATORËVE EKONOMIK QË OFROJNË FURNIZIME THELBËSORE:
09:00 - 10:30	2	- Ushqim
11:00 - 12:30	3	- Higjenë
13:00 - 14:30	4	- Farmaci
15:00 - 16:30	5 dhe 6	- Mjete medicinale
17:00 - 18:30	7	- Shërbime Bankare
19:00 - 20:30	8	
21:00 - 22:30	9	

Pas çdo intervali kohor si më lartë, operatorët ekonomik janë të detyruar që gjatë 30 minutëshit që nuk ka lëvizje të qytetarëve të bëjnë dezinfektimin e hapësirës afariste.

DATAT E QARKULLIMIT SIPAS ORARIT MËPOSHTË		18/04/2020 – 20/04/2020
ORARI I LËVIZJES	SHIFRA E PARAFUNDIT E NR PERSONAL	PËR LLOJIN E FURNIZIMEVE TË QYTETARËVE
07:00 - 08:30	5 dhe 6	DREJT OPERATORËVE EKONOMIK QË OFROJNË FURNIZIME THELBËSORE:
09:00 - 10:30	0	- Ushqim
11:00 - 12:30	1	- Higjenë
13:00 - 14:30	8	- Farmaci
15:00 - 16:30	7 dhe 9	- Mjete medicinale
17:00 - 18:30	2	- Shërbime Bankare
19:00 - 20:30	3	
21:00 - 22:30	4	

Pas çdo intervali kohor si më lartë, operatorët ekonomik janë të detyruar që gjatë 30 minutëshit që nuk ka lëvizje të qytetarëve të bëjnë dezinfektimin e hapësirës afariste.

DATAT E QARKULLIMIT SIPAS ORARIT MËPOSHTË		21/04/2020 – 23/04/2020
ORARI I LËVIZJES	SHIFRA E PARAFUNDIT E NR PERSONAL	PËR LLOJIN E FURNIZIMEVE TË QYTETARËVE
07:00 - 08:30	0 dhe 1	DREJT OPERATORËVE EKONOMIK QË OFROJNË FURNIZIME THELBËSORE:
09:00 - 10:30	2	- Ushqim
11:00 - 12:30	3	- Higjenë
13:00 - 14:30	4	- Farmaci
15:00 - 16:30	5 dhe 6	- Mjete medicinale
17:00 - 18:30	7	- Shërbime Bankare
19:00 - 20:30	8	
21:00 - 22:30	9	

Pas çdo intervali kohor si më lartë, operatorët ekonomik janë të detyruar që gjatë 30 minutëshit që nuk ka lëvizje të qytetarëve të bëjnë dezinfektimin e hapësirës afariste.

DATAT E QARKULLIMIT SIPAS ORARIT MËPOSHTË		24/04/2020 – 26/04/2020
ORARI I LËVIZJES	SHIFRA E PARAFUNDIT E NR PERSONAL	PËR LLOJIN E FURNIZIMEVE TË QYTETARËVE
07:00 - 08:30	5 dhe 6	DREJT OPERATORËVE EKONOMIK QË OFROJNË FURNIZIME THELBËSORE:
09:00 - 10:30	0	- Ushqim
11:00 - 12:30	1	- Higjenë
13:00 - 14:30	8	- Farmaci
15:00 - 16:30	7 dhe 9	- Mjete medicinale
17:00 - 18:30	2	- Shërbime Bankare
19:00 - 20:30	3	
21:00 - 22:30	4	

Pas çdo intervali kohor si më lartë, operatorët ekonomik janë të detyruar që gjatë 30 minutëshit që nuk ka lëvizje të qytetarëve të bëjnë dezinfektimin e hapësirës afariste.

DATAT E QARKULLIMIT SIPAS ORARIT MËPOSHTË		27/04/2020 – 30/04/2020
ORARI I LËVIZJES	SHIFRA E PARAFUNDIT E NR PERSONAL	PËR LLOJIN E FURNIZIMEVE TË QYTETARËVE
07:00 - 08:30	0 dhe 1	DREJT OPERATORËVE EKONOMIK QË OFROJNË FURNIZIME THELBËSORE:
09:00 - 10:30	2	- Ushqim
11:00 - 12:30	3	- Higjienë
13:00 - 14:30	4	- Farmaci
15:00 - 16:30	5 dhe 6	- Mjete medicinale
17:00 - 18:30	7	- Shërbime Bankare
19:00 - 20:30	8	
21:00 - 22:30	9	

Pas çdo intervali kohor si më lartë, operatorët ekonomik janë të detyruar që gjatë 30 minutëshit që nuk ka lëvizje të qytetarëve të bëjnë dezinfektimin e hapësirës afariste.

DATAT E QARKULLIMIT SIPAS ORARIT MËPOSHTË		01/05/2020 – 04/05/2020
ORARI I LËVIZJES	SHIFRA E PARAFUNDIT E NR PERSONAL	PËR LLOJIN E FURNIZIMEVE TË QYTETARËVE
07:00 - 08:30	5 dhe 6	DREJT OPERATORËVE EKONOMIK QË OFROJNË FURNIZIME THELBËSORE:
09:00 - 10:30	0	- Ushqim
11:00 - 12:30	1	- Higjienë
13:00 - 14:30	8	- Farmaci
15:00 - 16:30	7 dhe 9	- Mjete medicinale
17:00 - 18:30	2	- Shërbime Bankare
19:00 - 20:30	3	
21:00 - 22:30	4	

Pas çdo intervali kohor si më lartë, operatorët ekonomik janë të detyruar që gjatë 30 minutëshit që nuk ka lëvizje të qytetarëve të bëjnë dezinfektimin e hapësirës afariste.

**ANEKS 2 - INTERVALET KOHORE TË LEJIMIT TË LËVIZJES SË OPERATORËVE EKONOMIK:**

DATAT E QARKULLIMIT SIPAS ORARIT MËPOSHTË	15/04/2020 – 04/05/2020
06:00 – 24:00	DYQANET
00:00 – 24:00	FURNIZIMI DHE SHPËRNDARJA

Sipas listës NACE të ARBK-së,

KODI	VEPRIMTARITË E LEJUARA
4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani
4719	Tregti tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara
4721	Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara
4722	Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara
4723	Tregtia me pakicë të peshkut, krustacëve dhe molusqeve (frutave te detit) në dyqane të specializuara
4724	Tregtia me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, në dyqane të specializuara
4725	Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara
4726	Tregtia me pakicë e produkteve të duhanit në dyqane të specializuara
4729	Tregtia me pakicë e produkteve të tjera ushqimore në dyqane të specializuara
4730	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar
4773	Tregtia me pakice e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara (Barnatore)
4774	Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjekSORË, në dyqane të specializuara
4775	Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit, në dyqane të specializuara

KODI	VEPRIMTARITË E LEJUARA
0111	Kultivimi i drithërave (përveç orizit), i bimëve bishtajore dhe i farërave vajore
0112	Kultivimi i orizit
0113	Kultivimi i perimeve, pjepërave dhe shalqirit, bimëve rrëniore dhe tuberoze
0114	Kultivimi i kallamshequerit
0115	Kultivimi i duhanit
0116	Kultivimi i bimëve fibroze
0119	Kultivimi i bimëve të tjera njëvjeçare
0121	Kultivimi i hardhive
0122	Kultivimi i frutave tropikale dhe subtropikale
0123	Kultivimi i agrumeve
0124	Kultivimi i frutave me bërthamë dhe frutave me farë
0125	Kultivimi i frutave të tjera pemore, shkurreve dhe arrave
0126	Kultivimi i frutave vajore
0127	Kultivimi i kulturave për prodhimin e pijeve
0128	Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore
0129	Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare
0130	Shumimi i bimëve
0141	Rritja e gjedheve për qumësht
0142	Rritja e gjedheve të tjera dhe buallicave
0143	Rritja e kuajve dhe njëthundrakëve
0144	Rritja e gamileve dhe deveve
0145	Rritja e deleve dhe dhive
0146	Rritja e derrave
0147	Rritja e shpezëve
0149	Rritja e kafshëve të tjera
0150	Fermat e përziera
0161	Veprimtaritë ndihmëse për prodhimet bimore
0162	Veprimtaritë ndihmëse për prodhimet blegtorale
0163	Veprimtaritë e paskorries së bimëve
0164	Përpunimi i farërave për shumim
0170	Gjuetia, vënia e pusive dhe veprimtaritë e tjera shërbyses
0210	Kulturat pyjore dhe veprimtaritë e tjera të pylltarisë
0220	Prerja e drunjve
0230	Mbledhja e produktive pyjore të egra, jo drusore, rritur në natyrë
0240	Shërbime mbështetëse ndaj pyjeve
0510	Nxjerrja e qomyrit të fortë
0520	Nxjerrja e linjiteve
0610	Nxerrja e naftës së papërpunuar
0620	Nxerrja e gazit natyror
0710	Nxjerrja e xehes së hekurit
0721	Nxjerrja e xeheve të uranumit dhe toriumit
0729	Nxjerrja e xeheve të tjera jo-metalore
0811	Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gjipsit, shkumësit dhe rrasave
0812	Nxjerrja e zhavorrit dhe rërës, nxjerrja e argjillës dhe kaolinit

0891	Nxjerrja e mineraleve kimike dhe plehërave kimikë
0892	Nxerrja e torfës
0893	Nxjerrja e kripës
0899	Veprimtaritë e tjera nxjerrëse dhe gurore p.k.t.
1011	Përpunimi dhe konservimi i mishit
1012	Përpunimi dhe konservimi i mishit të shpezëve
1013	Prodhimi i produkteve të mishit dhe i mishit të shpezëve
1020	Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve
1031	Përpunimi dhe konservimi i patates
1032	Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve
1039	Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve
1041	Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave
1042	Prodhimi i margarinës dhe yndyrnave të tjera të ngashme
1051	Prodhimi i produkteve të qumështit
1052	Prodhimi i akullores
1061	Përpunimi i produkteve të drithërave
1062	Përpunimi i niseshtës dhe i produkteve të niseshtes
1071	Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta
1072	Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar
1073	Prodhimi i makaronave, shpagetave dhe produkteve të ngashme nga mielli
1081	Prodhimi i sheqerit
1082	Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe ëmbëlsirave
1083	Përpunimi i çajit dhe kafes
1084	Përpunimi i erëzave dhe salcave
1085	Përpunimi i ushqimeve dhe gjellëve të gatshme
1086	Përpunimi i ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike
1089	Përpunimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t
1091	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës
1092	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake
1101	Destilimi, rafinimi dhe kombinimi i pijeve
1102	Prodhimi i verës nga rrushi
1103	Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash
1104	Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padestiluara
1105	Prodhimi i birrës
1106	Prodhimi i majës së birrës
1107	Prodhim i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe
1200	Prodhimi i produkteve të duhanit
1310	Përgatitja dhe thurja e fijeve të tesktilit
1320	Endja e tekstilit
1330	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit
1391	Prodhimi i pëlhirave të thurura dhe të endura
1392	Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve
1393	Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve
1394	Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave

1395	Prodhimi i pëlhirave të paendura dhe artikujve të paendur, përvëç veshjeve
1396	Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale
1399	Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t
1411	Prodhimi i veshjeve të lëkurës
1412	Prodhimi i veshjeve të punës
1413	Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme
1414	Prodhimi i veshjeve të brendshme
1419	Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)
1420	Prodhimi i artikujve nga gëzofë
1431	Prodhimi i çorapeve të thurura
1439	Prodhimi i rrabave të tjera të thurura ose të punuara me grep
1512	Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve
1520	Prodhimi i këpucëve
1610	Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria
1621	Prodhimi i fletëzave të rimesos dhe të panelave bazuar në dru (furniri)
1622	Prodhimi i parketit për dysheme
1623	Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese
1624	Prodhimi i kontejnerëve nga druri
1629	Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse
1711	Prodhimi i brumit të letrës
1712	Prodhimi i letrës dhe kartonit
1721	Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit
1722	Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitari, letrës së tualetit
1723	Prodhimi i materialit prej letrës për zyre
1724	Prodhimi i tapetave të mureve
1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.
1812	Shtypje të tjera
1813	Shërbimet e përgatitjeve para-shtypjes dhe para-publikimit
1814	Libërlidhja dhe shërbime të ngjashme
1820	Riprodhimi i mediave të incizuara
1910	Prodhimi i produkteve të furrës së koksit
1920	Prodhimi i produkteve të rafinuara të naftës
2011	Prodhimi i gazrave industriale
2012	Prodhimi i ngjyrave dhe pigmenteve
2013	Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike
2014	Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike
2015	Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit
2016	Prodhimi i plastikës në formë primare
2017	Prodhimi i gomës sintetike në formë primare
2020	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike
2030	Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës
2041	Prodhimi i sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim
2042	Prodhimin e parfumeve dhe preparateve të tualetit

2051	Prodhimi i eksplozivëve
2052	Prodhimi i ngjitësve
2053	Prodhimi i vajrave esenciale
2059	Prodhimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.
2060	Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificialë
2110	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike
2120	Prodhimi i preparatave farmaceutike
2211	Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; veshja dhe riparimi i gomave
2219	Prodhimi i produkteve të tjera të gomës
2221	Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve
2222	Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim
2223	Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari
2229	Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës
2311	Prodhimi i qelqit të rrafshët
2312	Formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët
2313	Prodhimi i qelqit bosh (i zbrazët)
2314	Prodhimi i fibrave të qelqit
2319	Prodhimi dhe përpunimi i produkteve të tjera prej qelqi, duke përfshirë edhe mallrat teknike prej qelqi
2320	Prodhimi i produkteve rezistuese ndaj zjarrit
2331	Prodhimi i tullave dhe tjegullave prej qeramike
2332	Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve ndërtimore në argjilë të pjekur
2341	Prodhimi i produkteve të qeramikës për përdorim shtëpiak dhe zbukurues
2342	Prodhimi i pajisjeve sanitare prej qeramikës
2343	Prodhimi i izolatorëve prej qeramikës dhe pajisjeve izoluese
2344	Prodhimi i produkteve të tjera teknike prej qeramikës
2349	Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramikës
2351	Prodhimi i çimentos
2352	Prodhimi i gëlqeres dhe llaçit
2361	Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi
2362	Prodhimi i produkteve prej llaçit për qëllime ndërtimi
2363	Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim
2364	Prodhimi i llaçeve
2365	Prodhimi i fibrave të çimentos
2369	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betonit, llaçit dhe çimentos
2370	Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare
2391	Prodhimi i produkteve gjerryese
2399	Prodhimi i produkteve minerale jometalike p.k.t.
2410	Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferrolegurave
2420	Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku
2441	Prodhimi i metaleve të çmuara
2442	Prodhimi i aluminit
2443	Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit
2444	Prodhimi i bakrit

2445	Prodhimi i metaleve të tjera jo-ferrike
2511	Prodhimi i konstrukcioneve metalike dhe pjesëve të tyre
2512	Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit
2521	Prodhimi i radiatorëve dhe kazanëve për ngrohje qendrore
2529	Prodhimi i tankerëve, rezervuarëve dhe kontejnerëve të tjerë prej metalit
2530	Prodhimi i gjeneratorëve të avullit, përveç kazanëve për ngrohje qendrore
2540	Prodhimi i armëve dhe municionit
2571	Prodhimi i thikave
2572	Prodhimi i bravave dhe cilindrade
2573	Prodhimi i veglave
2591	Prodhimi i kovave të çelikta dhe mbajtësve të tjerë të ngjashëm
2592	Prodhimi i ambalazheve prej metalit të lehtë
2593	Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe suste
2594	Prodhimi i vidave dhe kaçavidave
2599	Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t.
2611	Prodhimi i përbërësve elektronikë
2612	Prodhimi i pllakëzave të integruese elektronike
2620	Prodhimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike
2630	Prodhimi i pajisjeve të komunikimit
2640	Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorë
2651	Prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve të matjes, testimit, verifikimit dhe navigimit
2652	Prodhimi i orëve dhe orëve të murit
2660	Prodhimi i pajisjeve për rrezatim, elektromjekësore dhe elektroterapeutike
2670	Prodhimi i instrumenteve optike dhe pajisjeve fotografike
2680	Prodhimi i mjeteve optike dhe magnetike të komunikimit
2711	Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe transformatorëve
2712	Prodhimi i aparaturave të shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike
2720	Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve
2731	Prodhimi i kabllove të fibrave optikë
2732	Prodhimi i telave dhe kabllove të tjera elektrike dhe elektronike
2733	Prodhimi i pajisjeve elektroinstaluese
2740	Prodhimi i pajisjeve elektrike të ndriçimit
2751	Prodhimi i pajisjeve elektrike shtëpiake
2752	Prodhimi i pajisjeve jolelektrike shtëpiake
2790	Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike
2811	Prodhimi i motorëve dhe turbinave, përveç motorëve të aeroplanëve, automjeteve dhe motoçikletave
2812	Prodhimi i pajisjeve hidraulike
2813	Prodhimi i pompave dhe kompresorëve të tjerë
2814	Prodhimi i rubinetave dhe valvulave
2815	Prodhimi i kushinetave, ingranazheve, grupeve të ingranazheve dhe elementeve të drejtimit
2821	Prodhimi i furrave, furrnaltave (kalldajave) dhe aparaturave për djegie
2822	Prodhimi i pajisjeve të ngritjes dhe zhvendosjes
2823	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve të zyrave, përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike
2824	Prodhimi i veglave mekanike të dorës
2825	Prodhimi i pajisjeve jo shtëpiake për ftohje dhe ventilim

2829	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm të p.k.t.
2830	Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore
2841	Prodhimi i makinerive për punimin e metaleve
2849	Prodhimi i veglave të tjera të makinave p.k.t.
2891	Prodhimi i makinerive për metalurgjinë
